

FJALA E DEPUTETES ERALDA BANO

E HËNË 11 PRILL 2022

E nderuar zonja Kryetare e Kuvendit,

Të nderuar kolegë,

Të dashur qytetarë,

Kongresi i Partisë Socialiste, përveçse nuk solli asgjë të re, ishte Kongresi me bilancin më dramatik në Shqipëri. Në këtë kohë krize u bë përsëri show spektakolar me propagandë tipike komuniste, duke folur për arritje imagjinare, plane që hidhen vetëm si kapsolla që plasin dhe lënë në memorie vetëm tym e zhurmë. Dëgjova ministren e Shëndetësisë të trumbetonte se në muajin korrik do të ketë rritje rrogash për mjekët. Me siguri sot fakti që kemi 16,47 mjekë për 10 mijë banorë, krahasuar me mesataren e vendeve të Europës, me 46,7 mjekë për 10 mijë banorë për ministren është një situatë alarmante. Situata është edhe më dramatike, nëse vërehen faktet konkrete.

Situata është edhe më dramatike, kur ndër specializimet afatgjata, kuotat e përcaktuara ishin 316 të miratuara në total. Sakaq, në specializime këtë vit janë regjistruar 290 mjekë, pa marrë parasysh se një pjesë shumë e madhe e mjekëve, që nisin specializimet, janë ndërkohë në proces për t'u larguar nga vendi. Pavarësisht faktit se largimi i mjekëve është fenomen global, ajo që nuk mund të anashkalohet është se Shqipëria nuk mund ta tolerojë më një eksod të tillë për vetë raportet e disfavorshme të dala nga OBSH-ja, të cilat e hedhin përtokë propagandën e ministrisë. A e keni marrë mundimin t'i lexoni sondazhet, të cilat tregojnë arsyet e largimit të tyre? Përqindja më e madhe e mjekëve largohet për shkak të kushteve të punës dhe këtu nuk flas vetëm për anën materiale.

Problem janë sekserët e "Rilindjes", të cilët janë administratorë që bëjnë ligjin nëpër spitale. Këta matrapazë, me shkollë nate, vendosin për ekzaminimet që do të kryejnë ose jo apo edhe koordinojnë të gjithë punën e spitalit. Sot nëpër drejtoritë e institucioneve shëndetësore ka çdolloj njeriu, veç profesionistëve të fushës. Sipas investigimit nga "Network Albania", Lasparaginaza, një bar kemioterapeutik është në mungesë. Kjo situatë ka detyruar prindërit të fëmijëve, të cilët vuajnë nga sëmundjet tumorale, t'ua blejnë këtë medikament përmes kontrabandës. Një nder i vogël nga shitësit u ka kushtuar këtyre qytetarëve 1350 euro. Si mundet ta përballojnë familjet shqiptare të gjithë këtë shumë apo, fundja, 140 euro u dalin familjeve?! Sipas INSTAT-it, nga xhepat e familjeve shqiptare kanë dalë 430 milionë euro për shërbime shëndetësore gjatë vitit 2020, shumë larg mbulimit shëndetësor universal që ministrja jonë e nderuar e përmend si arritje. Sipas OKBsë, shifra të tilla konsiderohen si shpenzime katastrofike në shëndetësi.

Për t'u kthyer edhe një herë te Kongresi famëkeq i Rilindjes, me çdo ngjarje, deklaratë dhe sjellje arrogante, jam e bindur se në agjendën e qeverisë autokrate prevalon koncepti i shpopullimit të Shqipërisë. Jo më kot përmenda largimin e mjekëve si shembull, pasi largimi i tyre është më i dukshmi

në thelb, por edhe përbën edhe dramën më të madhe të largimit të intelektualëve nga vendi. Në fakt, ekzaktësisht, kjo është “lufta e klasave” e kohës sonë. Faleminderit!